UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 497
Datë: 12/4/2021

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në Prishtinë, lidhur me procesin e zgjedhjes dhe avancimeve akademike të rregulluara me nenin 173 pika 1 dhe nenit 176 të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe në bazë të veprimeve procedurale të rregulluara me nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit nr. 05/l-031 për Procedurën e përgjithshme administrative dhe në bazë të kompetencave të shprehura me nenin 48 të Statutit të UP-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 12. 04. 2021 merr:

VENDIM

1. Konkursi i shpallur nga Senati i Universitetit të Prishtinës Universiteti i Prishtinës, me datën 27.04.2018, nr. 1/173 ka përfunduar në kontekst të afatit ligjor të paraparë sipas nenit 14, pika 4 dhe 6 të Rregullores nr. 456, dt. 2.03.2018, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

2. Në nenin 14, paragrafi 6 të Rregullores nr. 456, dt. 2.03.2018, është paraparë se në rast se konkursi nuk realizohet në tërësi apo pjesërisht brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 14, atëherë vendet përkatëse të parealizuara mund të rishpallen në konkursin e radhës sipas kërkesës së fakultetit. Prandaj mbi këtë bazë, lëndët të cilat kanë qenë të publikuara me konkursin si në pikën 1 të këtij vendimi dhe të cilat për arsye të ndryshme nuk kanë mundur të trajtohen apo për të cilat nuk është marr një vendim përfundimtar brenda afatit të përcaktuar si në paragrafin 4 dhe 5 të nenit 14 të Rregullores nr. 456, dt. 2.03.2018, për emërim, riemërim apo avancim të personelit përkatës akademik, të njëjtat mund të rishpallen sipas kërkesës së fakultetit.

3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi do të jetë lista me pozitat e shpallura sipas lëndëve që i takojnë kategorisë si në pikën 2 të këtij vendimi, respektivisht lëndët të cilat kanë ngelur pa një vendim përfundimtar për emërim.

4. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Arsyetim

Senati i Universitetit të Prishtinës me datë 27.04.2018, ka shpallë konkurs për emërim, riemërim dhe avancim të personelit akademik, nr. 1/173. Senati ka kërkuar që të respektohen procedurat sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren përkatëse, mirëpo duke pasur parasysh kriteret mjaft rigoroze dhe standardet e përcaktuara për emërim, riemërim dhe avancim, si dhe kontesteve të ngritura nga palët e ndryshme konkurrente, disa pozita/lëndë nuk kanë arritur që të përmbyllen brenda afatit ligjor për faktin se ato lëndë nga komisionet e njësive akademike nuk janë vlerësuar mbi bazën e kritereve të përcaktuara, prandaj si të tilla ato janë rikthyer për rivlerësim tek komisionet e njësive akademike dhe këshillat përkatëse. Disa prej pozitave/lëndëve nuk janë vlerësuar fare, apo për ato lëndë nuk janë formuar fare komisione vlerësuese për shkak të problemeve rreth fondit të orëve. Menaxhmenti i rektoratit në atë periudhë nuk e ka proceduar në Senat çështjen e nxjerrjes së vendimit për përfundim të procedurave të konkursit në fjalë

duke e vlerësuar se kjo është e nënkuptueshme sipas paragrafit 6 të nenit 14 të Rregullores nr. 456, dt. 2.03.2018, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", mirëpo duke pasur parasysh se disa palë kanë kërkuar në vazhdimësi që të pajisen me një vendim përfundimtar, duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana dhe tejkalimin e afatit të rregullt prej 175 ditësh dhe afatit plotësues prej 30 ditësh të lejuar nga rektori është tjekaluar qysh në fund të vitit 2018, Senati i UP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Arkivit të Universitetit;
2. Dekanëve të Fakulteteve përkatëse;
3. Sekretarëve të Fakulteteve përkatëse;
4. Kandidatëve;
5. Zyrës për Çështje Akademike;
6. Zyrës ligjore;

Senati i Universitetit të Prishtinës

Prof. Dr. Naser Sahiti, rektor

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" 1970 UNIVERSITY OF PRISHTINA

SHTOJCË 1

Lista e lëndëve mësimore nga Konkursi nr. 1/173, dt. 27.04.2018, për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Prishtinës të datës 27.04.2018, të cilat nuk janë realizuar, respektivisht nuk janë përmbyllur me një vendim përkatës.

I. FAKULTETI JURIDIK

1. Një asistent për lëndët: Ekonomia (O), Politika ekonomike (O), Qeverisje e korporatave (MOD) (O), Standardet e institucioneve shtetërore të raportimit financiar dhe auditimit (O).

2. Dy asistent për grup lëndësh në Katedrën Civile.

II. FAKULTETI EKONOMIK

1. Një mësimdhënës për lëndët: Sistemi integral i promocionit (O), Modelet kërkimore në marketing (Z), Marketingu në shitje me pakicë (Z), Principles of Management (O), Marketingu në turizëm (Z).

III. FAKULTETI I MJEKËSISË

1. Një mësimdhënës për lëndët: Kirurgji MP (O), Infermieria kirurgjike dhe onkologjike (I) (O), Kirurgji me traumatologji (FT) (O), Ndihma e parë (ST) (O).

2. Një mësimdhënës për lëndët: Kirurgji MP (O), Infermieria kirurgjike dhe onkologjike (I) (O), Kirurgji me traumatologji (FT) (O), Ndihma e parë (ST) (O).